



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

KURRIKULA E BAZUAR NË KOMPETENCA

Lënda: Gjeografi

**Shkalla: III
Klasa: VI-VII**

**Shkalla: IV
Klasa: VIII**

Tiranë, 2016



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT:

1.	FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”.....	2
1.1	Hyrje në programin e gjeografisë	4
2	KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT	6
2.1	Qëllimet e programit të gjeografisë	8
2.2	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës /lëndës.....	10
2.3	Lidhja e lëndës së gjeografisë me temat ndërkurrikulare	22
2.4	Lidhjet e lëndës së gjeografisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit	23
2.5	Kompetencat e fushës/lëndës dhe tematikat e saj.....	25
2.6	Koha mësimore për tematikë për secilën klasë	28
3.	REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E TRETË	31
4.	REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E KATËRT.....	47
5.	UDHËZIME METODOLOGJIKE	63
6.	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN	67
7.	MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE	68

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi: të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësi:

- Kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot po

rritet, për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje e globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxitin zhvillimin intelektual të nxënësit duke i dhënë mekanizmat konceptuale dhe metodologjike, të cilët nxënësi mund t’i përdorë në situata të ndryshme, e ndihmojnë të prezantojë botën dhe të përballojë situata të ndryshme në jetën e tij.

Në shkallën e tretë (klasat 6-7) dhe të katërt (klasat 8-9), fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve Histori, Gjeografi, Qytetari. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme. Përmes kësaj fushe, nxënësi zhvillon bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillon konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Programet e gjeografisë, historisë dhe qytetarisë janë ngushtësisht të lidhura nga kompetencat që ato synojnë të zhvillojnë te nxënësi. Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxënësi në këtë shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyç, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

1.1 Hyrje në programin e gjeografisë

Gjeografia është shkenca e vendit, hapësirës dhe mjedisit. Ajo është një mënyrë e strukturuar e eksplorimit, analizës dhe shpjegimit të Tokës, banorëve të saj dhe marrëdhënieve të ndërsjella midis tyre. Mësimi i gjeografisë i ofron nxënësit mundësi të zhvillojë të kuptuarit e veçorive natyrore dhe shoqërore të mjedisit gjeografik, diversitetit të vendeve dhe rajoneve në botë, të njerëzve dhe kulturave, ndërvarësisë dhe ndërveprimit, si dhe marrëdhënieve të njeriut me mjedisin, në nivel lokal, kombëtar, rajonal e botëror.

Ndryshimet e shumta që po përjeton shoqëria e sotme, në mënyrë të veçantë përsa i takon komunikimit, kanë modifikuar marrëdhënien tonë me mjedisin. Shumëllojshmëria e informacionit dhe shpërndarja e tij marramendëse, shtimi i shkëmbimeve të llojeve të ndryshme, globalizimi i ekonomisë dhe lëvizjet e popullsisë, i bëjnë largësitë më të vogla dhe ndikojnë mënyrën sipas së cilës ne shohim botën. Në këtë kontekst, lënda e gjeografisë ka një rëndësi të veçantë për përgatitjen e nxënësit për të jetuar dhe për t'u integruar në shoqëri, për kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar, për edukimin për të jetuar së bashku dhe edukimin për zhvillim të qëndrueshëm.

Programi i gjeografisë kontribuon në zhvillimin e kompetencave kyç në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Zhvillimi i kompetencave është pikënisja dhe parimi bazë organizativ i këtij programi. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxënit.

Nxënësi përvetëson mjetet dhe gjuhën gjeografike teksa hulumton marrëdhënien e njeriut me vendet dhe mjedisin, dhe zbulon rolin që duhet të përmbushë për zhvillimin e qëndrueshëm.

Vëzhgimet dhe puna në terren, puna me hartën, interpretimi i shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore në Tokë dhe ndërvarësisë midis tyre, zhvillojnë shkathtësitë themelore gjeografike në këtë nivel shkollimi.

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të

ulët dhe plani mësimor i arsimit bazë. Si i tillë ky dokument i shërben:

-) **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
-) **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
-) **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit.
-) **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

2 KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Programi i gjeografisë për shkallën e tretë (kl.6-7) dhe të katërt (kl.8-9) të arsimit bazë është hartuar me një strukturë dhe mënyrë të re konceptimi në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

- J) Programi i gjeografisë krijon kushtet për ndërtimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe kompetencave të fushës që lidhen me to. Kompetencat e fushës lidhen me kompetencat kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënit të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës dhe kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor. Procesi i të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, në të gjitha shkallët, ka në fokus të veçantë zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare.
- J) Kompetencat zhvillohen përmes tematikave të përbashkëta të fushës dhe në program zërthehen në njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime/vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishëm të programit të gjeografisë, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Programi i gjeografisë për shkallët 3 dhe 4 të kurrikulës është i strukturuar rreth dy tematikave të mëdha. Për secilën prej tyre përcaktohen rezultatet e pritshme të shprehur në terma njohurish, shkathtësish dhe qëndrimesh. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave, ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të të nxënit për tematikë, duke qenë pjesë integrale e tyre.
- J) Strukturimi dhe organizimi i programit për shkallë kurrikule synon ta bëjë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar dhe lënë dorë më të lirë mësuesve për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, si dhe të respektojnë ritmet individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës.


-) Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënit për kompetencë ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e situatave të të nxënit dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe. Situatat e të nxënit janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënit. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxëni, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit.
-) Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Programi i gjeografisë krijon mundësi integrimi brenda fushës dhe me fushat e tjera, si shkencat e natyrës, matematikën, gjuhën, artet, etj. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare. Ato shërbejnë si çështje kyçe për zhvillimin e kompetencave, integrojnë fushat e të nxënit dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme.
-) Programi sugjeron metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre.
-) Vlerësimi si pjesë integrale e procesit të të nxënit, mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

2.1 Qëllimet e programit të gjeografisë

Programi i gjeografisë për shkallën e 3-të dhe të 4-ët synon që nxënësi:

- Të zhvillojë kuriozitetin për vendet, njerëzit, kulturat dhe mjediset në botë.
- Të zhvillojë dijet për dukuritë dhe proceset fiziko-gjeografike mbi bazën e një përgatitjeje të përshkallëzuar dhe ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues.
- Të zhvillojë kuptimin, interesin dhe respektin për vendin ku jeton, të vendeve të tjera, njerëzve dhe mënyrës si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë.
- Të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik.
- Të zhvillohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.
- Të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit.

Diagrama 1: Korniza konceptuale e programit



2.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës /lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të nxënies. Kompetenca përcaktohet si ndërthurje e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet të fitojë gjatë procesit të nxënies.

Kompetenca qytetare

Programi i gjeografisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, përmes kërkimit gjeografik krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.

Në shkallën e tretë dhe të katërt, nxënësi hulumton për çështje aktuale gjeografike, ai vlerëson gjetjet e tij në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore në nivel lokal e global, diversitetin dhe respektimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në zonën ku jeton etj.. Përmes eksplorimit të çështjeve të tilla, nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike, të marrë vendime dhe të veprojë për adresimin e çështjeve qytetare në një botë të ndërvarur dhe diverse. Nxënësi propozon rrugë alternative për sfida apo çështje të ndryshme gjeografike, duke marrë në konsideratë faktorët mjedisorë, ekonomikë, shoqërorë.

Ky program kontribuon dhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënies të synuara nga programi i gjeografisë nxitin, në shkallë të ndryshme, zhvillimin e kompetencave kyçe.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i gjeografisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset gjeografike, vendet dhe rajonet. Ai mëson si të vlerësojë këto burime dhe kuptojë si

gjuha mund të përdoret për të manipuluar të nxënin. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve apo prezantimeve zhvillon shkathtësi të të shprehurit; në mënyrë progresive zhvillon dhe përdor fjalorin gjeografik për komunikimin e informacionit dhe ideve në audiencë të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe analizon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategji që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren. Nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe krijuese për mënyrat e përdorimit sa më racional të burimeve natyrore.

Programi i gjeografisë mundëson zbatimin e shkathtësive matematike për ndërtimin e grafikëve, tabelave, llogaritjen dhe interpretimin e të dhënave. Në punën me hartën, nxënësit punojnë me koncepte numerike, si shkalla, largësia, koordinatat, projeksionet.

Kompetenca e të nxënit

Për të mbështetur kërkimin gjeografik, nxënësit përdor metoda efektive të punës, shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur konsideron pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur pozicionohet dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme gjeografike e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Ai mëson ku është dhe si, pozita e tij lidhet me të tjerët. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në

procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e gjeografisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin gjeografik, analizojnë elementë të situatës, kompleksitetin e saj, vlerësojnë rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme gjeografike e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësit mësojnë të bashkëpunojnë ndërsa përballen me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

Kompetenca personale

Programi i gjeografisë stimulon të nxënin bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur heton, krijon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë gjeografike, për vendin e tij, marrëdhënien e njeriut me mjedisin.

Diagrama 2:

Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë në shkallën e tretë (kl.6 -7)

SHKALLA 3

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

Nxënësi:

-) Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
-) Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
-) Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
-) Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TVetj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

Nxënësi:

-) Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media.
-) Zgjidh një problem(shoqëror, shkencor...etj)dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
-) Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi(shkencor,shoqëror)duke paraqitur rezultat të njëjtë.
-) Interpreton mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
-) Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.
-) Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

Kompetenca e të nxënës (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

Nxënësi:

-) Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
-) Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
-) Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim(tekst shkollor, libër, internet, media)për të nxënë një temë,veprim,aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
-) Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të

shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.

- J Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- J Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

Nxënësi:

- J Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- J Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- J Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)

Nxënësi:

- J Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

Nxënësi:

-) Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
-) Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

Nxënësi:

-) Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
-) Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

Diagrama 3:

Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë në shkallën e katërt (kl.8 – 9)

SHKALLA 4

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)

Nxënësi:

-)] Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
-)] Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshetuar forma të komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik.
-)] Harton një tekst, deri në pesëqind fjalë (bazuar në imagjinatën e vet), duke vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar më parë.
-)] Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun e përshtatshëm.

Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)

Nxënësi:

-) Paraqet në forma të ndryshme (me gojë, të shkruar, grafike, me simbole) argumente për të përforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.
-) Përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.
-) Përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar qëllimin, aktivitetet kryesore, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre dhe parashikon pengesat e mundshme gjatë realizimit.
-) Interpretin një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situatat e jetës së përditshme me shkrim/me gojë.
-) Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.

Kompetenca e të nxënit (Nxënësi mëson për të nxënë)

Nxënësi:

-) Regjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/faktet për një temë; veçon me anë të teknikave të ndryshme pjesët sipas rëndësisë dhe nevojës për temën/detyrën e dhënë.

-) Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje/projektme bazë klase/shkolle ose jashtë saj.
-) Parashtron pyetje për çështje të ndryshme dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke evidentuar përparimin/vështirësitë deri në zgjidhjen përfundimtare.
-) Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënës të temës së dhënë, duke klasifikuar informacionin e njohur nga ai panjohur, si dhe atë që është i paqartë.
-) Përdor elementët e portofolit personal për vetëvlerësimin dhe identifikimin e anëve të forta, i shfrytëzon ato për përparimin në mësim dhe për orientimin për karrierë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)

Nxënësi:

-) Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme.
-) Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe biodiversitetit, duke i paraqitur idetë në formë të shkruar ose në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, jep mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje si dhe organizon aktivitete për mbrojtjen e mjedisit.

Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme)

Nxënësi:

-) Dallon sjelljen korrekte nga ajo jo korrekte gjatë punës në grup ose në situata emocionale, dhe propozon masat për parandalimin/tejkalimin e tyre.

Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)

Nxënësi:

-) Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, shkollë apo në komunitet, mban qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete parandalimi.
-) Përgatit në grup një aktivitet, duke përdorur tolerancën si mjet për promovimin e diversiteti kulturor, etnik, gjinor, fetar, social etj., në shkollë apo në komunitet.

Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)

Nxënësi:

-) Përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënës dhe për të rritur efektivitetin në mësimnxënie.
-) Bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur mjetet e telekomunikacionit bashkëpunues, për të hetuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj.
-) Përdor aftësitë e të menduarit kritik për të planifikuar, hulumtuar e menaxhuar projekte, për të zhvilluar strategji, për të zgjidhur problemet dhe, arrin në vendimmarrje, në bazë të informacionit të fituar, duke përdorur mjetet dhe burimet e duhura digjitale.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

-) përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të gjeografisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
-) planifikon mësimdhënien, duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit, për kompetencat kyçe brenda vitit shkollor;
-) kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë, për lëndën e gjeografisë.

2.3 Lidhja e lëndës së gjeografisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, me fokus të veçantë temat:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedis.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë me mjedisin nga perspektiva e menaxhimit të përgjegjshëm, nxënësi mëson të vendosë lidhje midis nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për implikimet e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e mjedisit nga veprimtaria njerëzore. Në këtë mënyrë, programi ndihmon për edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin. Përmes studimit të vendeve dhe rajoneve të ndryshme, transferimit të të nxënit në vendin e tij, nxënësi ndërgjegjësohet për rolin e tij si qytetar. Kjo e ndihmon atë të jetë mendjehapur dhe të respektojë diversitetin. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare, dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë kupton domethënien e veprimeve në një territor të caktuar, pozicionohet për një çështje të caktuar dhe hulumton dukuritë globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

2.4 Lidhjet e lëndës së gjeografisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

Konceptimi i programit të gjeografisë në fushën” Shoqëria dhe mjedisi” është mbështetur në parime të mirëfillta të integritimit. Për t’i siguruar nxënësit zhvillimin e kompetencave, është e rëndësishme lidhja e lëndëve brenda fushës, të cilat ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën.

Lidhja e gjeografisë me historinë i shërben nxënësit të kuptojë më mirë vendin e tij dhe ndryshimet përgjatë kohërave; ndryshimet që kanë pësuar kulturat e ndryshme dhe ndikimin e tyre në zhvillimet e vendeve dhe rajoneve; nxënësi hulumton historinë e mendimit gjeografik për të kuptuar evolucionin e ideve dhe teorive.

Programi i gjeografisë ka si pjesë përbërëse përmasat e qytetarisë dhe ndihmon në zhvillimin e tyre. Ai e sheh botën si bashkësi globale dhe të ndërvarur, nxënësi identifikon probleme, sugjeron zgjidhje dhe reflekton për marrjen e vendimeve.

Gjeografia është ngushtësisht e lidhur me fushat e tjera të të nxënit. Si të gjitha lëndët e tjera, gjeografia krijon mundësi të zbatimit të kompetencave që zhvillon fusha “Gjuhët dhe komunikimi”. Nxënësi zhvillon aftësitë dhe shprehitë e tij komunikuese, me shkrim dhe me gojë, për të kërkuar dhe komunikuar gjetjet e tij. Ai përdor gjuhën letrare për të shprehur pozicionin e tij qartë dhe në mënyrë koherente. Por njëkohësisht dhe gjeografia kontribuon në zgjerimin dhe përpunimin e fjalorit të nxënësit, duke e nxitur atë të parashtrojë qartë dhe saktësisht idetë e tij, me gojë ose me shkrim. Punët praktike, të cilat janë mjaft të rëndësishme për zhvillimin e kompetencave të kësaj lënde, i japin nxënësit shansin që të zhvillojë kompetencën e komunikimit gjuhësor dhe të pasurojë fjalorin terminologjik, përmes diskutimeve mbi përshkrimin e punëve praktike dhe shpjegimin e rezultateve të tyre. Termat e ndryshëm të përdorur në këtë lëndë janë specifike dhe ndihmojnë nxënësin për zhvillimin e kompetencës së komunikimit në gjuhën dhe terminologjinë e saj.

Gjithashtu, e rëndësishme është lidhja e gjeografisë me shkencat e natyrës. Gjeografia është një urë lidhëse ndërmjet shkencave natyrore dhe atyre shoqërore. Shumë prej njohurive të fushës së shkencave natyrore janë themelore për interpretimin e mënyrës sipas

së cilës janë organizuar vendet dhe në këtë mënyrë për të përfutur një kuptim më të mirë të dukurive globale. P.sh., nxënësi përdor njohuritë për dukuritë natyrore kur diskuton për organizimin e mjediseve të ndryshme. Përmes studimit të vendeve dhe rajoneve, nxënësi reflekton mbi pasojat në shkallë të gjerë të ndikimit të njeriut në çështje të shëndetit. P.sh., ai ndërgjegjësohet që sjellje të papërgjegjshme mund të çojnë në përhapjen e epidemive apo ndotjeve mjedisore. Ai kupton që vendimet e marra në bazë të interesave të ngushta mund të kenë pasojë serioze për njerëzit që banojnë në një mjedis të rrezikuar.

Nxënësi zhvillon kompetencën matematikore përmes përdorimit të informacioneve sasiore dhe cilësore, leximit apo ndërtimit të hartave, grafikëve dhe tabelave statistikore.

Artet, në mënyrë të veçantë arti pamor, i jep mundësi nxënësit të zbulojë peizazhe dhe qendra të banuara përmes prezantimeve të artistëve. Ai percepton ndikimin e artit në arkitekturën, zhvillimin e shesheve publike etj. Dhe lëndët e tjera të arteve ndihmojnë përmes krijimit dhe interpretimit të punimeve që i referohen perspektivës hapësinore.

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet të nxënit në lëndën e gjeografisë përmes realizimit të detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit. Nxënësi mëson të përzgjedhë informacionin dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tij, të dallojë faktin nga opinioni.

2.5 Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Përmes programit të gjeografisë, në shkallën e tretë dhe të katërt të kurrikulës mundësohet zhvillimi i kompetencave të lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyç që një nxënës duhet të zotërojë gjatë gjithë jetës së tij/saj. Programi i gjeografisë, nëpërmjet të gjithë tematikave të tij dhe situatave të të nxënësit zhvillon dhe ndërton kompetencat e lëndës, të cilat janë pjesë e kërkimit gjeografik. Nxënësit zhvillojnë dhe ndërtojnë kompetencat si dhe aftësohen t'i përdorin ato në mënyrë që të thellojnë dhe të zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre në lëndën e gjeografisë duke arritur progres.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave, do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënësit të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, mobilizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to.

Disa nga shkathtësitë janë specifike për gjeografinë (p.sh., nxënësit lokalizojnë, orientohen në hapësirë, lexojnë dhe përdorin gjuhën hartografike), ndërsa të tjerat kanë të bëjnë me shkathtësi që gjeografia ndan me fushat e tjera dhe që janë të domosdoshme për të gjithë procesin e të nxënësit (p.sh., komunikojnë me shkrim dhe me gojë, përshkruajnë, identifikojnë etj.). Çdo situatë të nxënësit shoqërohet domosdoshmërisht me shumë prej këtyre shkathtësive.

Në shkallën e tretë dhe të katërt, programi i gjeografisë zhvillon kompetencat e mëposhtme lëndore, të cilat lidhen me kërkimin gjeografik:

-) *Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike*
-) *Përpunimi i informacionit gjeografik*
-) *Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur*

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës për shkallën e tretë dhe të katërt:

SHKALLA 3	SHKALLA 4
Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike	Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formulon dhe drejton pyetje për çështjen gjeografike për të cilën zhvillohet kërkimi gjeografik. - Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij ose duke formuluar hipoteza. - Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike, që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës dhe në mjedisin lokal. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcakton ose zhvillon një çështje për hetim. - Zhvillon dhe vlerëson çështjen duke përdorur konceptet që lidhen me rajonin, mjedisin, ndërveprimin. - Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të ndërveprimit ndërmjet mjediseve fizike dhe humane në rajone të ndryshme, në nivel lokal, kombëtar, rajonal e botëror.
Përpunimi i informacionit gjeografik	Përpunimi i informacionit gjeografik
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim. - Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. - Ndërton njohuri për mjedisin lokal dhe proceset e dukuritë gjeografike në gjeosistem, duke përdorur mjetet dhe shkathtësitë gjeografike, si hartat, vëzhgimet në terren fottografi, etj. - Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledh, përzgjedh dhe regjistron të dhëna gjeografike, duke shfrytëzuar burimet parësore dhe dytësore. - Nxënësi vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. - Ndërton njohuri për rajonet dhe veçoritë e tyre, ndërvarësinë, bashkëveprimin midis tyre, në nivel kombëtar, rajonale e global, duke përdorur mjetet dhe shkathtësitë gjeografike, si harta të llojeve të ndryshme, fotografi, statistika, diagrama, pyetësorë etj.

përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

- Prezanton (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

Marrja e vendimeve

Nxënësi:

- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjetje kyç.
- Nxënësi identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.
- Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërkimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet”.

Marrja e vendimeve

Nxënësi:

- Kombinon të dhëna dhe informacion për të nxjerrë konkluzione, duke marrë në konsideratë impaktin e tyre.
- Propozon alternativa, strategji apo zgjidhje për çështjen gjeografike dhe jep argumente për zgjedhjen e preferuar.
- Sugjeron mënyra të përmirësimit të metodave të tij/saj kërkimore.

2.6 Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Programi i gjeografisë për shkallën e 3-të (klasa 6-7) zhvillohet për 105 orë mësimore (35 orë mësimore për klasën e 6-të, dhe 70 orë mësimore për klasën e 7-të). Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë dhe nëntematikë, për secilën shkallë dhe klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

SHKALLA 3

Tematika	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Proceset natyrore dhe shoqërore
Klasa 6	35 orë	
Klasa 7	8 orë	62 orë

Klasa 6

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara ¹
----------	--------------	--------------------------------

¹ Orët për nëntematikat janë sugjeruese. Mësuesit janë të lirë të planifikojnë dhe shpërndajnë sipas nëntematikave orët në dispozicion për secilën klasë, në varësi të interesave dhe nevojave të nxënësve.

Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Gjeografia dhe kërkimi gjeografik	8
	Hartat gjeografike	12
	Mjedisi ynë lokal	15

Klasa 7

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara
Proceset natyrore dhe shoqërore	Toka në hapësirë	8
	Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë	54
Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin	8

Programi i gjeografisë për shkallën e 4-t (klasa 8-9) zhvillohet për 140 orë mësimore (70 orë mësimore për klasën e 8-të, dhe 70 orë mësimore për klasën e 9-të). Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë dhe nëntematikë, për secilën shkallë dhe klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë/nëntematikë.

SHKALLA 4

Tematika	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve
Klasa 8	70 orë
Klasa 9	70 orë

Klasa 8

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara
Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Rajonet dhe rajonizimi	6
	Evropa	32
	Rajonet e tjera të botës	32

3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E TRETË

Në programin e gjeografisë për shkallën e tretë janë paraqitur rezultatet e të nxënit për tematikat “Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve, mjediseve” dhe “Proceset natyrore dhe shoqërore” në funksion të zhvillimit të kompetencave. Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve). Sasia e orëve mësimore për secilën nëntematikë është rekomanduese.

KLASA 6

Tematika: Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve

Përshkrimi i tematikës:

Përmes tematikës “Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve” nxënësit zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, kuptojnë vendndodhjen e njerëzve, të vendeve rajoneve dhe burimeve si dhe përshkruajnë arsyet e kësaj vendndodhjeje. Nxënësit eksplorojnë si kanë ndikuar dhe ndikojnë ngjarjet historike, faktorët fizikë dhe humanë në zhvillimin vendor, rajonal, kombëtar dhe global. Ato vëzhgojnë dhe debatojnë rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe propozojnë krahasojnë e vlerësojnë alternativat e përdorimit të burimeve natyrore në komunitete, rajone, kombe dhe në botë.

Në klasën e 6-të, përmes kësaj tematike nxënësit përvetësojnë njohuri, zhvillojnë shkathtësi dhe qëndrime në lidhje me konceptet

bazë të kërkimit gjeografi, metodat e mjetet që përdoren për të zhvilluar kompetencën e kërkimit gjeografik. Programi synon aftësimin e nxënësve në punën me hartën. Studimi i tipareve natyrore dhe humane të mjedisit lokal i mundëson nxënësit vëzhgimin dhe hetimin e dukurive gjeografike në këtë mjedis.

Rezultatet e të nxënit

Gjeografia dhe kërkimi gjeografik

Njohuritë	Shkathësitë	Qëndrimet / vlerat
<p>) Gjeografia dhe konceptet bazë të kërkimit gjeografik: vendndodhja/vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi dhe zhvillimi.</p> <p>) Kërkimi gjeografik: metodat dhe mjetet gjeografike që përdoren për të realizuar kërkimin gjeografik.</p> <p>) Gjeografi dhe roli i tij në studimin e dukurive gjeografike.</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Demonstron</u> përmes shembujve kuptim të koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vendndodhja/ vendi, - mjedisi, - rajoni, - ndërveprimi, - zhvillimi. <p>) <u>Përshkruan</u> metodat shkencore të kërkimit gjeografik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i burimeve parësore dhe dytësore. - analiza dhe interpretimi i të dhënave. <p>) <u>Diskuton</u> mbi rolin e gjeografit në</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <u>Demonstron</u> interes për gjeografinë, degët e saj dhe karrierat që lidhen me të. - <u>Paraqet dhe komunikon</u> <u>lirshëm</u> mendimet e tij. - <u>Respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.

studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike, kontributet që i sjellin shoqërisë.

) Diferencon ngjarje të rëndësishme të historisë së zhvillimit gjeografik.

Hartat gjeografike

-) Paraqitja grafike e Tokës: Harta, plani, globi, dallimet dhe ngjashmëritë midis tyre
-) Hartat gjeografike, llojet e hartave dhe përdorimi i tyre
-) Vendndodhja gjeografike: absolute dhe relative
-) Harta e Shqipërisë; Shqipëria në Ballkan, Evropë dhe botë

Nxënësi:

-) Krahason hartën, planin dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.
-) Dallon lloje të ndryshme të hartave gjeografike dhe përdorimet e tyre.
-) Përdor TIK-un:
 - për të gjetur harta elektronike të llojeve të ndryshme;
 - për të përcaktuar vendndodhjen dhe largësinë midis dy vendeve.
-) Shpjegon legjendën e një harte gjeografike;
-) Mat distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme;
-) Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.
-) Dallon:
 - paraqitjen e Shqipërisë në harta të llojeve të ndryshme;

Nxënësi:

-) Demonstron kuriozitet në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.
-) Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.
-) Respekton idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.
-) Prezanton me objektivet rezultatet e ndryshme.

	<ul style="list-style-type: none"> - vendndodhjen gjeografike (absolute dhe relative) të Shqipërisë në hartën e Ballkanit, Evropës dhe botës.) <u>Përshkruan</u> një itinerar në hartë kur janë dhënë drejtimet kryesore të lëvizjes dhe objekte gjeografike të dallueshme. 	
--	--	--

Mjedisi ynë lokal

<ul style="list-style-type: none">) Tiparet kryesore të mjedisit natyror të zonës (qytetit/fshatit) së banimit) Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në ndryshimin e mjedisit natyror të zonës) Popullsia, shtimi natyror, struktura moshore e popullsisë, lëvizjet e saj dhe faktorët që ndikojnë dhe kanë ndikuar në këto lëvizje) Vendbanimet dhe mënyra e jetesës së njerëzve në mjedisin lokal) Trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit lokal dhe mbrojtja e saj) Aktivitetet prodhuese dhe organet e qeverisjes lokale e qendrore të mjedisit që na rrethon 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) <u>Interpreton</u> në hartë vendndodhjen e zonës (qytetit/fshatit) ku banon.) <u>Përshkruan</u>:) përbërësit kryesorë të relievit duke dalluar elementë të veçantë;) burimet ujore (burime, lumenj, liqene, dete etj.);) botën bimore dhe shtazore;) mikroklimën në mjedisin ku jeton.) <u>Vëzhgon</u> dhe <u>sjell shembuj</u> si kanë ndikuar këto burime në jetën e banorëve; - <u>Diskuton</u> mbi rrugët nëpërmjet të cilave njerëzit kanë shfrytëzuar pasuritë natyrore (p.sh., përdorimi i gurëve, rërës, ndërtimi i 	<p><u>Nxënësi:</u></p> <ul style="list-style-type: none">) <u>Pranon dhe respekton diversitetin natyror, shoqëror, kulturor të zonës</u> ku banon.) <u>Demonstron përkujdesje dhe ndjeshmëri</u> për burimet natyrore dhe ruajtjen e tyre.) <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.) <u>Respekton idetë dhe përvojat</u> e prezantuara nga të tjerët.
--	--	--

J Zhvillimi mjedisor dhe bashkëveprimi komunitar për mbrojtjen e tij

hidrocentraleve etj.).

- Përshkruan strukturën moshore të popullsisë në zonën ku jeton;
- Mbledh të dhëna statistikore për të shpjeguar lëvizjet e popullsisë së zonës në periudha të ndryshme dhe shkaqet.
- Dallon karakteristikat kryesore të vendbanimeve në qytetin/fshatin e tij.
- Krahason mënyrën e jetesës së popullsisë në mjedisin e tij lokal me atë të popullsisë në mjedise të tjerë.
- Evidenton:
 - monumentet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës;
 - vlerat turistike që kanë monumentet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës;
 - rreziqet natyrore dhe antropogjene që kërcënojnë vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës.
- J Identifikon llojet kryesore të veprimtarive prodhuese ekonomike, industriale dhe

tregtare në mjedisin lokal.

) Përcakton vendndodhjen e rrugëve lokale e kombëtare, të ndërtesave të qeverisjes lokale e qendrore, objektet e edukimit të nxënësve, parqe, biblioteka etj.

- Parashtron ide (me shkrim dhe me gojë) mbi ndikimin e veprimtarisë së njeriut në mjedisin natyror të zonës dhe nevojën e bashkëpunimit komunitet – qeverisje lokale për mbrojtjen e mjedisit;

) Përdor hartën topografike të qytetit/fshatit për t'u orientuar në mjedisin e tij lokal.

KLASA 7

Tematika: Proceset natyrore dhe shoqërore

Përshkrimi i tematikës:

Proceset natyrore dhe shoqërore përfshijnë zhvillimet dhe ndryshimet që ndodhin në mjedisin natyror dhe shoqëror, në nivel vendor, rajonal dhe global. Njohja e këtyre proceseve, e ligjshmërisë dhe e lidhjeve shkak-pasojë është domosdoshmëri për vendimmarrjet tona.

Në klasën e 7-të, nxënësit zhvillojnë kompetencën e kërkimit gjeografik dhe kompetencat kyçe përmes zbulimit dhe argumentimit shkencor të lidhjeve shkak-pasojë në dukuritë dhe proceset që ndodhin në sistemet natyrore të planetit tonë. Programi synon formimin e qëndrimeve ndaj zhvillimeve lokale dhe globale, si dhe përgatitjen e nxënësve për të dhënë kontribut aktiv në mbrojtjen e mjedisit.

Rezultatet e të nxënit

Toka në hapësirë

Njohuritë

Shkathtësitë

Qëndrimet / vlerat

<p> J Lëvizjet e Tokës dhe pasojat gjeografike të tyre: rrotullimi i Tokës rreth vetes dhe lëvizja rreth Diellit </p>	<p> Nxënësi: J <u>Përshkruan</u>: - formën e Tokës; - përmasat dhe rëndësinë e tyre; - pozicionin e Tokës në sistemin diellor. J <u>Identifikon</u> provat që tregojnë se Toka rrotullohet rreth boshtit të saj. J <u>Ndërton dhe përdor modele</u>: - që tregojnë lidhjen ndërmjet rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe gjatësisë së ditës; - që përshkruajnë pozicionin e Tokës kundrejt Diellit në ditët e ekuinokseve dhe solsticeve. </p>	<p> Nxënësi: Ñ <u>Tregon objektivitet</u> kur kërkon të dhëna dhe informacion për të bërë të vlefshme shpjegimet e tij mbi formën dhe përmasat e Tokës. Ñ <u>Paraqet dhe komunikon lirshëm</u> mendimet e tij. Ñ <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale. Ñ <u>Demontron bashkëpunim</u> gjatë punës në grup për përgatitjen e modeleve. </p>
---	--	---

Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë

<p> J Atmosfera - Rrezatimi diellor, rrezatimi bazë për planetin tonë - Temperatura e ajrit, lagështira, shtypja </p>	<p> Nxënësi: J <u>Modelon</u> strukturën vertikale të atmosferës duke përdorur informacion nga burime të ndryshme të të nxënit. </p>	<p> Nxënësi: Ñ <u>Tregon objektivitet</u> kur kërkon të dhëna për treguesit e motit dhe klimës. </p>
---	---	---

<p>atmosferike, era</p> <ul style="list-style-type: none"> - Moti - Klima, zonat klimatike - Veprimtaria e erës dhe format e relievit që krijohen prej saj - Veprimtaria njerëzore dhe ndërveprimi me modelet dhe proceset atmosferike 	<p>) <u>Dallon</u> brezat e nxehtësisë dhe rëndësinë e rrezatimit diellor, si rrezatimi bazë për planetin tonë.</p> <p>) <u>Përshkruan</u>:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkaqet dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë; - ndikimin e saj në qarkullimin e rrymave oqeanike dhe erërave. <p>) <u>Shpjegon</u> marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin si ndryshim afatshkurtër i këtyre treguesve.</p> <p>) <u>Përdor</u>:</p> <ul style="list-style-type: none"> - instrumentet për matjen e temperaturës së ajrit, shtypjes atmosferike, lagështirës dhe përcaktimin e drejtimit të erës, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin; - harta sinoptike për të bërë parashikime të motit. <p>) <u>Përshkruan</u> klimën si rezultat i modeleve afatgjatë të temperaturës, reshjeve.</p>	<p>Ñ <u>Paraqet dhe komunikon</u> <u>lirshëm</u> mendimet e tij.</p> <p>Ñ <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Ñ <u>Demontron bashkëpunim</u> gjatë punës në grup për përgatitjen e modeleve dhe kryerjen e detyrave/projekteve.</p>
--	---	--

-) Identifikon:
- faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;
 - zonat kryesore klimatike në hartë.
-) Sjell shembuj si modelet globale ndikojnë mikroklimën (p.sh., rryma e Golfstrimit, pasojat në klimën e Evropës veriperëndimore);
-) Ndërton dhe interpretton grafikë klimatike për zona të ndryshme.
-) Argumeton rëndësinë e proceseve dhe modeleve të klimës për jetën dhe proceset në Tokë (p.sh., thatësira, turizmi) dhe rolin e veprimtarisë njerëzore (p.sh.shtimi i gazeve serë).
-) Identifikon disa ndër pasojat dhe format e relievit që krijohen nga veprimtaria gërryese, transportuese dhe depozituese e erës.
-) Interpretton lidhjen e hidrosferës me

) Hidrosfera

- Ujërat e oqeaneve dhe deteve, veçoritë e tyre, lëvizjet e ujit të oqeaneve
- Veprimtaria gërryese, transportuese dhe depozituese në brigjet detare
- Lumenjtë, tipet e lumenjve dhe veprimtaria e ujërave rrjedhës
- Liqenet dhe origjina e krijimit të tyre
- Ujërat nëntokësorë, shfrytëzimi i tyre dhe veprimtaria e karstit
- Veprimi i borës dhe i akujve
- Veprimtaria njerëzore dhe ndikimet e saj në sistemet ujore

litosferën, atmosferën, biosferën;

) Identifikon veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve (temperatura, kripësia, dendësia);

) Bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë:

- valët detare
- rrymat oqeanike
- baticat dhe zbaticat.

) Skicon në hartë drejtimin e lëvizjes dhe rrugën që ndjekin disa nga rrymat oqeanike dhe përshkruan rolin e tyre në klimën e rajoneve që përshkojnë.

) Identifikon, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshëm, elementët përbërës të lumit dhe llojet e lumenjve.

) Përcakton drejtimet kryesore të shtrirjes së disa lumenjve në hartën e botës dhe Shqipërisë.

) Krahason liqene me origjinë të ndryshme, duke sjellë shembuj dhe përcaktuar

vendndodhjen e tyre në hartë.

) Vëzhgon në zonën (qytetin/fshatin) e tij praninë e burimeve dhe diskuton për llojin dhe përdorimin e tyre.

) Identifikon disa ndër pasojat dhe format e relievit që krijohen nga veprimtaria gërryese, transportuese dhe depozituese në brigjet detare , e ujërave rrjedhës dhe karstit.

) Përshkruan formimin e borës dhe akujve dhe veprimin e tyre në mjedis.

) Heton për një çështje mjedisore që lidhet me ujrat (p.sh., erozioni lumor, tharja e një liqeni artificial etj.) në zonën e tij:

- identifikon problemin;
- përcakton faktorët e mundshëm që e shkaktojnë;
- ofron zgjidhje;
- vlerëson përfitimet dhe rrisqet e zgjidhjeve të mundshme.

) Modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës

) Litosfera

- Lëvizja e pllakave
- Format e relievit
- Shkëmbinjtë
- Dherat
- Historia e Tokës
- Tërmetet dhe vullkanet
- Ndryshimi i sipërfaqes së Tokës nga forcat e brendshme

duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.

) Klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vulkanikë.

) Identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave.

) Argumenton rëndësinë e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjtë, mineralet) për shoqërinë.

) Nxjerr përfundime për proceset historike që kanë kontribuar në format e tokës:

- Lëvizjet e kontinenteve përgjatë kohërave
- Pllakat tektonike

) Diferencon format kryesore të relievit të kontinenteve dhe bën dallimin e tyre në hartë.

) Identifikon në hartë vendet me lartësi absolute të ndryshme.

) Krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e lëvizjeve të ngadalta (p.sh. formimi i maleve) dhe proceseve të shpejta (tërmetet, vullkanet).

<p>) Biosfera</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bota bimore dhe shtazore. 	<p>) <u>Demonstron</u> në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</p> <p>) <u>Identifikon</u> faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.</p>	
---	---	--

Tematika: Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjedisve

Përshkrimi i tematikës:

Përmes kësaj tematike nxënësit zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, kuptojnë vendndodhjen e njerëzve, të vendeve, rajoneve dhe burimeve si dhe përshkruajnë arsyet e kësaj vendndodhjeje. Nxënësit eksplorojnë si kanë ndikuar dhe ndikojnë faktorët fizikë dhe humanë në zhvillimin vendor, rajonal, kombëtar dhe global. Ato vëzhgojnë dhe debatojnë rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe propozojnë krahasojnë e vlerësojnë alternativat e përdorimit të burimeve natyrore në komunitete, rajone, kombe dhe në botë.

Rezultatet e të nxënit

Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin

Njohuritë	Shkathësitë	Qëndrimet / vlerat
<p>Ñ Hapësirat bregdetare, si hapësira të jetës njerëzore dhe mbrojtja e tyre.</p> <p>Ñ Ndotja në qendrat urbane.</p> <p>Ñ Ndotja në zonat rurale.</p> <p>Ñ Ndërvarësia e ndikimeve mjedisore.</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Diskuton</u> mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare, përmes shembujve nga vendi dhe bota.</p> <p>) <u>Heton</u> disa ndër problematikat e krijuara si pasojë e ndërhyrjeve të veprimtarisë së njerëzve (p.sh., ndërtimet e shumta dhe pa kriter, mungesa e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza etj):</p> <ul style="list-style-type: none"> - në një zonë bregdetare; - në një qendër urbane; - në një zonë rurale. <p>) <u>Vlerëson</u> ndërvarësinë globale të ndikimeve mjedisore (p.sh., transferimi i ndotjes).</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>Ñ <u>Respekton</u> diversitetin natyror të mjedisëve të ndryshëm.</p> <p>Ñ <u>Demonstron përgjegjshmëri</u> në shfrytëzimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore.</p> <p>Ñ <u>Paraqet dhe komunikon lirshëm</u> mendimet e tij.</p> <p>Ñ <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përfuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>) <u>Demontron bashkëpunim</u> gjatë punës në grup për përgatitjen e modeleve dhe kryerjen e detyrave/projekteve.</p>

4. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E KATËRT

Në programin e gjeografisë për shkallën e katërt janë paraqitur rezultatet e të nxënimit për tematikën “Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve, mjediseve” në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Rezultatet e të nxënimit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Tematikat, nëntematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxënimit, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (me kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve). Sasia e orëve mësimore për secilën nëntematikë është rekomanduese.

KLASA 8

TEMATIKA: Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve

Përshkrimi i tematikës:

Përmes kësaj tematike, nxënësit zhvillojnë kompetencat që lidhen me kërkimin gjeografik për studimin e rajoneve të ndryshme të botës, veçorive të tyre, marrëdhënien e ndërsjellë midis mjedisit fizik dhe human në vendet dhe rajonet e ndryshme në botë, shpjegimin e ndërveprimeve të shoqërisë njerëzore me mjedisin gjeografik.

Nxënësit jo vetëm marrin njohuri për rajonizimin, rajonet dhe nënrajonet e mëdha të botës, por ato zhvillojnë aftësi të kërkimit gjeografik për të zgjeruar në mënyrë të pavarur informacionin dhe njohuritë mbi këto rajone. Nxënësit përdorin hartat, prezantimet grafike, mjetet dhe teknologjinë e informacionit për të gjetur, përdorur dhe prezantuar informacion rreth rajoneve, vendeve dhe

mjediseve të ndryshme; përdorin shprehitë praktike në ndërtimin e grafikëve, diagrameve, skicave, matjeve dhe lokalizimeve në hartë ; përdorin fjalorin e përshtatshëm gjeografik; organizojnë udhëtime imagjinare, konkurse me karakter gjeografik, përgatisin albume për rajone e vende të veçanta etj.

Rezultatet e të nxënit

Njohuritë	Shkathtësitë	Qëndrimet / vlerat
Rajonet dhe rajonizimi		
<p>J Rajon, rajonizim gjeografik, gjeografi rajonale.</p> <p>J Tipet e rajoneve: rajonet fizikë dhe humane (ekonomikë, kulturorë, demografikë):</p> <ul style="list-style-type: none"> - rajonet fizikë; - shpërndarja e popullsisë në botë; - shpërndarja hapësinore e gjuhëve dhe besimeve fetare; - vendet e zhvilluara dhe vendet 	<p>Nxënësi:</p> <p>J <u>Shpjegon</u> pse gjeografët krijojnë dhe përdorin rajonet si koncepte organizuese;</p> <p>J <u>Përdor</u> konceptin e vendit dhe të rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis vendeve dhe rajoneve.</p> <p>J <u>Identifikon</u> tipet kryesorë të rajoneve në botë.</p> <p>J <u>Lokalizon</u> në hartë dhe <u>interpret</u>on rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë.</p> <p>J <u>Interpret</u>on grafikë, diagrama etj., që përshkruajnë dinamikën e popullsisë referuar shpërndarjes hapësinore.</p> <p>J <u>Prezanton</u> dhe <u>komunikon</u> përmes hartës së <u>botës</u> shpërndarjen hapësinore të besimeve më</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>Ñ <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor dhe mjedisor.</p> <p>Ñ <u>Demonstron</u> kuriozitet për rajonet dhe vendet në botë.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p> <p>Ñ <u>Paraqet dhe komunik</u>on lirshëm mendimet e tij.</p> <p>Ñ <u>Respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.</p> <p>J <u>Tregon integritet</u> në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit.</p> <p>J <u>Është krijues</u> dhe prezanton idetë e reja të tij.</p>

<p>në zhvillim.</p> <p>) Bashkëveprimi dhe ndërvarësia midis rajoneve.</p>	<p>të mëdha fetare dhe gjuhëve kryesore.</p> <p>) <u>Bën dallimin</u> ndërmjet tipareve të rajoneve të zhvilluar dhe atyre në zhvillim përmes shembujve tipikë (shoqëruar me interpretimin në hartë).</p> <p>) <u>Sjell shembuj</u> të bashkëveprimit dhe ndërvarësisë midis rajoneve në aspektin ekonomik, politik, kulturor, mjedisor etj.</p>	
--	--	--

Evropa

<p>) Evropa, pozita gjeografike dhe veçoritë kryesore fiziko-gjeografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; - hidrografia; - bota e gjallë; - marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit. 	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Interpreton</u> me ndihmën e hartës pozitën gjeografike të Evropës, rolin e saj në marrëdhënien dhe lidhjet me rajonet e tjera.</p> <p>) <u>Identifikon dhe interpreton në hartë</u> njësitë e mëdha fiziko-gjeografike të Evropës.</p> <p>) <u>Lokalizon dhe përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (hartat, CD, foto, video etj.).</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Demonstron</u> kuriozitet në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>) <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>) <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p> <p>) <u>Prezanton me objektivitet</u> rezultatet e ndryshme.</p>
---	---	--

<p>J Popullsia e Evropës dhe dinamika e saj.</p>	<p>J <u>Analizon</u> të dhëna dhe <u>nxjerr përfundime</u> për dinamikën e popullsisë së Evropës.</p> <p>J <u>Krahason</u> dhe <u>gjen ndryshimet e ngjashmëritë</u> e kulturave në Evropë, duke sjellë shembuj të respektimit të diversitetit kulturor.</p>	<p>J <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor dhe mjedisor.</p> <p>Ñ <u>Demonstron</u> <u>kuriozitet</u> për vendet dhe rajonet.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve.</p>
<p>J Tipare të përgjithshme të zhvillimit urban në Evropë.</p>	<p>J <u>Identifikon</u> veçoritë kryesore të zhvillimit të sotëm urban në Evropë.</p>	
<p>J Tipare të përgjithshme të zhvillimit ekonomik të hapësirës evropiane.</p>	<p>J <u>Sjell fakte dhe të dhëna</u> që dëshmojnë larminë e zhvillimit ekonomik të hapësirës evropiane.</p>	
<p>J Rajonet kryesore të Evropës, veçoritë e tyre kryesore fiziko-geografike dhe humane (demografike, kulturore, ekonomike dhe urbane):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Evropa perëndimore; 	<p>J <u>Identifikon ngjashmëritë dhe dallimet</u> në veçoritë kryesore fiziko-geografike dhe humane të rajoneve të Evropës.</p> <p>J <u>Përshkruan</u> veçoritë kryesore fiziko-geografike dhe humane të rajonit të Evropës perëndimore.</p>	

- | | | |
|--|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - Evropa veriore; | <ul style="list-style-type: none">) <u>Përshkruan</u> veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Evropës veriore. | |
| <ul style="list-style-type: none"> - Evropa ishullore; | <ul style="list-style-type: none">) <u>Përshkruan</u> veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Evropës ishullore. | |
| <ul style="list-style-type: none"> - Evropa mesdhetare; | <ul style="list-style-type: none">) <u>Përshkruan</u> veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Evropës mesdhetare.) <u>Eksploron</u> potencialet turistike të rajonit të Mesdheut.) <u>Identifikon</u> disa nga pasojat ekonomike dhe mjedisore që vijnë si pasojë e zhvillimit të turizmit në rajonin e Mesdheut. | |
| <ul style="list-style-type: none"> - Evropa lindore. | <ul style="list-style-type: none">) <u>Përshkruan</u> veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Evropës lindore.) <u>Vlerëson</u> pozitën gjeografike të Shqipërisë | |

si urë lidhëse midis Evropës perëndimore dhe lindore, mundësitë e përfshirjes hap pas hapi të saj në të gjitha rrjedhat euroatlantike, rolin e saj në bashkëpunimin ndërrajonal e më gjerë.

) Përdor hartat për të interpretuar veçoritë e secilit rajon të Evropës;

) Lokalizon dhe përzgjedh informacionin në lidhje me rajonet e Evropës nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.).

) Prezanton informacionin me shkrim ose me gojë, shoqëruar me harta, grafikë, të dhëna, prezantime multimediale, në lidhje me rajonet e Evropës.

) Bashkimi Evropian nga perspektiva gjeografike.

) Përshkruan historinë e formimit, zhvillimit e zgjerimit të Bashkimit Evropian.

) Identifikon dhe ndan ide për disa nga problemet e sotme rajonale të Evropës dhe perspektivën e zgjidhjes së tyre.

Rusia

<p> J Rajoni i Ruisë, tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike: <ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; - hidrografia; - bota e gjallë, me fokus katet e bimësisë. J Popullsia dhe zhvillimi ekonomik i Ruisë në botën moderne (burimet minerare dhe rëndësia e tyre). </p>	<p>Nxënësi:</p> <p> J <u>Identifikon dhe interpreton me ndihmën e hartës</u> tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike të rajonit të Ruisë. </p> <p> J <u>Dallon</u> veçoritë e popullimit dhe natyrën e zhvillimit ekonomik të Ruisë në botën moderne. </p> <p> J <u>Lokalizon dhe përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (hartat, CD, foto, video etj.). </p>	<p>Nxënësi:</p> <p> J <u>Demonstron kuriozitet</u> në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme. </p> <p> J <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale. </p> <p> J <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët. </p> <p> J <u>Prezanton me objektivitet</u> rezultatet e ndryshme. </p> <p> J <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor dhe mjedisor. </p>
---	--	---

Amerika e Veriut

<p> J Amerika e Veriut, pozita </p>	<p>Nxënësi:</p> <p> J <u>Interpreton</u> me ndihmën e hartës, pozitën </p>	<p>Nxënësi:</p> <p> J <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin </p>
---	--	---

<p>gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; - hidrografia; - bota e gjallë. <p>) Veçoritë e popullimit të rajonit.</p> <p>) Zhvillimi ekonomik në Amerikën e Veriut dhe shpërndarja hapësinore e tij.</p>	<p>gjeografike të Amerikës së Veriut dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.</p> <p>) <u>Identifikon</u> dhe <u>interpretin në hartë</u> veçoritë fiziko-gjeografike të Amerikës së Veriut.</p> <p>) <u>Analizon</u> të dhëna dhe <u>nxjerr përfundime</u> për veçoritë e popullimit të këtij rajoni dhe shkallën e ndikimit të imigracionit në tiparet e popullsisë dhe kulturës së sotme.</p> <p>) <u>Dallon</u> tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të Amerikës së Veriut.</p> <p>) <u>Përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e <u>interpretin</u> atë.</p>	<p>social, kulturor dhe mjedisor.</p> <p>) <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.</p> <p>) <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p> <p>) <u>Demonstron kuriozitet</u> në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>) <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>ñ <u>Vlerëson bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
--	---	---

Amerika e Mesme

<p>) Amerika e Mesme, pozita</p>	<p>Nxënësi:) <u>Interpretin</u> me ndihmën e hartës, pozitën</p>	<p>Nxënësi:) <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin</p>
----------------------------------	--	---

<p>gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; - hidrografia; - bota e gjallë. <p>) Veçoritë e popullimit dhe kulturës së rajonit.</p> <p>) Zhvillimi ekonomik në Amerikën e Mesme dhe shpërndarja hapësinore e tij.</p>	<p>gjeografike të Amerikës së Mesme dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.</p> <p>) <u>Identifikon</u> dhe <u>interpretton në hartë</u> veçoritë fiziko-gjeografike të Amerikës së Mesme.</p> <p>) <u>Identifikon</u> veçoritë e popullimit dhe kulturës së këtij rajoni.</p> <p>) <u>Dallon</u> tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së Amerikës së Mesme.</p> <p>) <u>Përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e <u>interpretton</u> atë.</p>	<p>social, kulturor dhe mjedisor.</p> <p>) <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.</p> <p>) <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p> <p>) <u>Demonstron kuriozitet</u> në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>) <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
--	---	---

Amerika e Jugut

<p>) Amerika e Jugut, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - relievi; 	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Interpretton</u> me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të Amerikës së Jugut dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor dhe mjedisor.</p> <p>) <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e</p>
--	--	--

<ul style="list-style-type: none"> - klima; - hidrografia; - bota e gjallë. <p>J Veçoritë e popullimit të rajonit.</p> <p>J Zhvillimi ekonomik në Amerikën e Jugut dhe shpërndarja hapësinore e tij.</p>	<p>J <u>Identifikon</u> dhe <u>interpretin në hartë</u> veçoritë fiziko-gjeografike të Amerikës së Jugut.</p> <p>J <u>Identifikon</u> veçoritë e popullimit dhe kulturës së këtij rajoni.</p> <p>J <u>Dallon</u> tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së këtij rajoni.</p> <p>J <u>Përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e <u>interpretin</u> atë.</p>	<p>të dhënave krahasuar me ato të shokëve.</p> <p>J <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p> <p>J <u>Demonstron</u> kuriozitet në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>J <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
---	--	--

Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore

<p>J Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; - hidrografia; - bota e gjallë. 	<p>Nxënësi:</p> <p>J <u>Interpretin</u> me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.</p> <p>J <u>Identifikon</u> dhe <u>interpretin në hartë</u> veçoritë fiziko-gjeografike të Afrikës Veriore dhe</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>J <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor dhe mjedisor.</p> <p>J <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.</p> <p>J <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p>
---	---	--

<p>) Veçoritë e popullimit dhe kulturës së rajonit.</p> <p>) Zhvillimi ekonomik në Afrikën Veriore dhe Azinë Jugperëndimore dhe shpërndarja hapësinore e tij.</p>	<p>Azisë Jugperëndimore.</p> <p>) <u>Identifikon</u> tiparet e popullimit dhe kulturës së këtij rajoni.</p> <p>) <u>Dallon</u> tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së këtij rajoni.</p> <p>) <u>Përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e <u>interpreton</u> atë.</p>	<p>) <u>Demonstron</u> <u>kuriozitet</u> në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>) <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson</u> <u>bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
---	--	---

Afrika Nënsahariane

<p>J Afrika Nënahariane, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; - hidrografia; - bota e gjallë. <p>J Veçoritë e popullimit të rajonit.</p> <p>J Zhvillimi ekonomik në Afrikën Nënahariane dhe shpërndarja hapësinore e tij.</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>J <u>Interpreton</u> me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të Afrikës Nënahariane dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.</p> <p>J <u>Identifikon</u> dhe <u>interpreton në hartë</u> veçoritë fiziko-gjeografike të Afrikës Nënahariane.</p> <p>J <u>Identifikon</u> veçoritë e popullimit dhe kulturës së këtij rajoni.</p> <p>J <u>Dallon</u> tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së këtij rajoni.</p> <p>J <u>Përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e <u>interpreton</u> atë.</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>J <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor dhe mjedisor.</p> <p>J <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.</p> <p>J <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p> <p>J <u>Demonstron kuriozitet</u> në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>J <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
---	--	--

Azia Lindore

	Nxënësi:	Nxënësi:
--	----------	----------

<p>)] Azia Lindore, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; - hidrografia; - bota e gjallë. <p>)] Veçoritë e popullimit të rajonit.</p> <p>)] Zhvillimi ekonomik në Azinë Lindore dhe shpërndarja hapësinore e tij.</p>	<p>)] <u>Interpreton</u> me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të Azisë Lindore dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.</p> <p>)] <u>Identifikon</u> dhe <u>interpreton në hartë</u> veçoritë fiziko-gjeografike të Azisë lindore.</p> <p>)] <u>Identifikon</u> veçoritë e popullimit dhe kulturës së këtij rajoni.</p> <p>)] <u>Dallon</u> tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së këtij rajoni.</p> <p>)] <u>Përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e <u>interpreton</u> atë.</p>	<p>)] <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor dhe mjedisor.</p> <p>)] <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.</p> <p>)] <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p> <p>)] <u>Demonstron kuriozitet</u> në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>)] <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
Azia Juglindore		
<p>)] Azia Juglindore, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike:</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>)] <u>Interpreton</u> me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të Azisë Juglindore dhe rolin e</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>)] <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor</p>

<ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; - hidrografia; - bota e gjallë. <p>) Veçoritë e popullimit të rajonit.</p> <p>) Zhvillimi ekonomik në Azinë Juglindore dhe shpërndarja hapësinore e tij.</p>	<p>saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.</p> <p>) <u>Identifikon</u> dhe <u>interpret</u>on në hartë veçoritë fiziko-gjeografike të Azisë Juglindore.</p> <p>) <u>Identifikon</u> veçoritë e popullimit dhe kulturës së këtij rajoni.</p> <p>) <u>Dallon</u> tiparet kryesore të modelit të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.</p> <p>) <u>Përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e <u>interpret</u>on atë.</p>	<p>dhe mjedisor.</p> <p>) <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.</p> <p>) <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p> <p>) <u>Demonstron</u> kuriozitet në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>) <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
---	--	--

Azia Jugore

<p>) Azia Jugore, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; 	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Interpret</u>on me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të Azisë Jugore dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.</p> <p>) <u>Identifikon</u> dhe <u>interpret</u>on në hartë</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor dhe mjedisor.</p> <p>) <u>Vlerëson me objektivitet</u></p>
--	--	---

<ul style="list-style-type: none"> - hidrografia; - bota e gjallë. <p>) Veçoritë e popullimit të rajonit.</p> <p>) Zhvillimi ekonomik në Azinë Jugore dhe shpërndarja hapësinore e tij.</p>	<p>veçoritë fiziko-gjeografike të Azisë Jugore.</p> <p>) <u>Identifikon</u> veçoritë e popullimit dhe kulturës së këtij rajoni.</p> <p>) <u>Dallon</u> tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së këtij rajoni.</p> <p>) <u>Përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e <u>interpreton</u> atë.</p>	<p>rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.</p> <p>) <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p> <p>) <u>Demonstron</u> kuriozitet në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>) <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson</u> bashkëpunimin ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
---	--	--

Australia dhe Oqeania

<p>) Australia dhe Oqeania, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - relievi; - klima; - hidrografia; - bota e gjallë. 	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Interpreton</u> me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të Australisë dhe Oqeanisë dhe rolin e saj në marrëdhëniet me rajonet e tjera.</p> <p>) <u>Identifikon</u> dhe <u>interpreton</u> në hartë veçoritë fiziko-gjeografike të Australisë</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>) <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.</p> <p>) <u>Vlerëson dhe respekton</u> diversitetin social, kulturor dhe mjedisor.</p>
--	---	--

<p>J Veçoritë e popullimit të rajonit.</p> <p>J Zhvillimi ekonomik në Australi dhe Oqeani dhe shpërndarja hapësinore e tij.</p>	<p>dhe Oqeanisë.</p> <p>J <u>Identifikon</u> veçoritë e popullimit dhe kulturës së këtij rajoni.</p> <p>J <u>Dallon</u> tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së këtij rajoni.</p> <p>J <u>Përzgjedh</u> informacionin në lidhje me këto veçori nga burime të ndryshme (harta, CD, foto, video etj.) dhe e <u>interpreton</u> atë.</p>	<p>J <u>Respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.</p> <p>J <u>Demonstron</u> <u>kuriozitet</u> në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.</p> <p>J <u>Ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Ñ <u>Vlerëson</u> <u>bashkëpunimin</u> ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
---	---	---

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies në lëndën e gjeografisë janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve të tyre.

Mësimdhënia dhe të nxënësve, i bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesit e kësaj lënde:

- të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve, që nënkupton përvojat individuale të tij dhe, mbi këtë bazë, të mbështesin e orientojnë të nxënësve të tij;
- të nxitin vërtetimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë;
- të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojnë nxënësve, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë komplementarë të njëri-tjetrit;
- të mbështesin të nxënësve të pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
- të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës” Shoqëria dhe mjedisi”, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore.
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës.
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Rolet që ndërmarrin nxënësi dhe mësuesi në realizimin e kësaj qasje janë:


- *Nxënësi - aktiv dhe i interesuar.* Në gjeografi, nxënësi studion dukuritë dhe proceset gjeografike, ndërton kuptimin për vendin e tij. Ai inkurajohet të kërkojë përgjigje për pyetjet që ngre, duke hulumtuar në burime të ndryshme dhe, duke përdorur teknika specifike të gjeografisë. Nxënësi angazohet të vendosë lidhje ndërmjet asaj që di dhe asaj që zbulon dhe mbi këtë bazë ndërton dijen e tij; bashkëvepron me shokët/shoqet dhe mësuesin, ndan me ta vëzhgimet dhe përvojat e tij. Ai punon individualisht ose në grup, dhe mbështetet nga mësuesi.
- *Mësuesi - udhëheqës dhe lehtësues.* Mësuesi i gjeografisë ndihmon nxënësit të zbulojnë kënaqësitë e të nxënësve. Roli i mësuesit konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai moderon kërkimin dhe eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesit veprojnë si moderatorë midis dijes dhe nxënësve, duke e ndihmuar nxënësin të përfshihet në procesin e ndëtimin të dijes. Ato krijojnë kontekste të nxënësve, të cilat i aftësojnë nxënësit të përftojë mjetet e gjeografisë. Zbatimi i programit kërkon që mësuesi të përdorë strategji mësimdhënieje duke respektuar stilet e të nxënësve të nxënësve. Ai i angazhon nxënësit në ndëtimin e mendimit, duke nxitur diskutimet dhe ballafaqimin e këndvështrimeve të ndryshme.

Situatat e të nxënësve në gjeografi duhet të jenë të larmishme dhe komplekse. Nxënësi duhet të përceptojë lidhjen ndërmjet përvojave të tij të të nxënësve dhe zbatimeve të ardhshme.

Situatat duhet të jenë të hapura, që do të thotë që nxënësi aftësohet të kërkojë zgjidhje të ndryshme për një çështje apo problem, dhe jo një zgjidhje të vetme apo një përgjigje të vetme. Situata të tilla përfshijnë detyra të ndryshme, favorizojnë përdorimin e mediave të ndryshme dhe rezultojnë me punime të llojeve të ndryshme.

Situatat e të nxënësve duhet të jenë komplekse, që do të thotë të përdoren burime të ndryshme të të nxënësve dhe nxënësve të punojnë së bashku. Kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e të dhënave duhet të jenë gjithmonë pjesë e situatave të të nxënësve. Ato duhet të mbështeten në kërkimin gjeografik, i cili përfshin analizën krahasuese të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme. Këto lloj situatash kërkojnë zhvillimin e shprehive të të pyeturit, analizës, mendimit kritik dhe krijues.

MODEL I NJË SITUATE KOMPLEKSE TË TË NXËNIT




Situata e të nxënit lidhet me hetimin e disa prej problematikave të krijuara si pasojë e ndërhyrjeve të veprimtarisë së njeriut (p.sh., ndërtimet e shumta dhe pa kriter, mungesa e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza etj):

- në një zonë bregdetare;
- në një qendër urbane;
- në një zonë rurale.

Nxënësit punojnë në grupe për secilin nga rastet studimore. Ata përdorin anketa, intervista, informacion të mbledhur nga vëzhgimet e drejtpërdrejta, nga foto apo harta, të dhëna statistikore të marra në burime të ndryshme informacioni për të hulumtuar në lidhje me to. Këto informacione i përpunojnë dhe i prezantojnë, duke propozuar rrugë të mundshme për zgjidhjen ose zbutjen e rasteve të ndryshme.

Nxënësi prezanton gjetjet e tij përmes grafikëve, tabelave, poëer point dhe i nterpreton ato.

Nxënësi zhvillon përgjegjësinë qytetare për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, kompetencën matematikore, komunikuese, të menduarin kritik dhe krijues.



Burime të të nxënit:

- Foto
- Harta
- Përvojat e nxënësit
- Informacion nga Interneti dhe media të ndryshme
- Materiale të tjerë

- Punë në grupe
- Punë individuale
- Diskutim
- Intervista
- Vëzhgime
- Punë me hartën

për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesit mund të zgjerojnë zhvillimin e kompetencave kyçe si ato të komunikimit, të menduarit dhe shoqërore sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

a) Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

b) Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe (p.sh.: aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës të të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit në nivel klase dhe shkalle. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësit, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësi të kompetencave të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”. Vlerësimi u shërben mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënit si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve.

Format e ndryshme të vlerësimit duhet t’u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara.

Përveç testeve me shkrim, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve duke përdorur mënyrat e mëposhtme si:

- | | |
|--|-----------------------|
| -punët praktike; | -modelet dhe maketet; |
| -projektet kurrikulare dhe ndërleëndore; | -lojërat dhe kuicet; |
| -detyrat individuale; | -debatet; |
| -vrojtimit e mësuesit; | -loja me role; |
| -listën e kontrollit; | -portofoli. |
| -esetë; | |

Mësuesi mund të vlerësojë nxënësin përmes përdorimit të portofolit. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësve dhe siguron një tablo të plotë të arritjes së tyre. Punët e mbledhura ofrojnë të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në

përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ai gjithashtu u afron nxënësve mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë, etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- Z Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Z Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet Eëb për gjeografinë.
- Z Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.

Z Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm software.

Z Përdorimi i simulimeve software.

Z Përdorimi i grafikëve software.

Z Paraqitja grafike e të dhënave.